

Thirrje për pjesëmarrje – Konkursi Ndërkombëtar i Aftësive; 25-31 Maj 2019, Kinë.

Në kuadër të nismës kineze “Një brez një rrugë” në datat 25-31 Maj 2019 do të mbahet në Chongqing, Kinë, Konkursi Ndërkombëtar i Aftësive. Organizatorët ftojnë 5 (pesë) pjesëmarrës nga Shqipëria, të cilët do të konkurojnë sipas një tematike të caktuar. Secili vend pjesëmarrës duhet të regjistrohet për konkurrim vetëm në dy tema/aftësi.

Konkursi sponsorizohet nga Ministria e Burimeve Njerëzore dhe Sigurimit Social dhe nga Bashkia Chongqing. Konkursi përmban 18 lloje aftësish.

Organizatorët mbulojnë të gjitha shpenzimet (biletat e transportit ajror ndërkombëtar, transportin tokësor, fjetjen dhe vaktet) për:

- 1 (një) koordinator;
- 2 (dy) konkurentë (të rinj deri në 25 vjeç) dhe
- 2 (dy) trajnerë.

[Lista e Aftësive](#)

[Formulari i Regjistrimit](#)

Kërkohet të dërgohen kandidaturat e 2 konkurentët (studentë në programet e studimeve profesionale ose program studimi Bachelor), të cilët do të konkurojnë sipas një tematike të caktuar (secili një tematikë ndryshe) nga ato të parashikuara si dhe 2 trajnerëve respektivë, shoqëruar me CV-në, ku do të pasqyrohen dhe njohuritë e gjuhës angleze, duke qenë se konkurimi do të kryhet në këtë gjuhë.

Trajneri duhet të jetë pedagog i studentit në një nga fushat që lidhen me aftësitë e parashikuara në listën përkatëse të përcjellë nga Ambasada Kineze.

Studenti duhet të jetë me mesataren e ponderuar më të lartë, të shoqëruar më certifikatën e notave të viteve të mëparshme dhe të vitit aktual të studimeve për ciklin që ndjek dhe të njohë shumë mirë gjuhën angleze.

Për një informacion më të detajuar lidhur me konkursin ndërkombëtar ju lutem klikoni në linkun <https://www.bris2019.com.cn/En-index.shtml>